

VENDIM
Nr.1623, datë 22.12.2008

PËR DHËNIE ASISTENCE EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PERSONAVE,
QË PËRFITOJNË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Përfitojnë asistencë ekonomike të menjëhershme, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë:

a) personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) personat, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c) veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, personat, që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe personat, që marrin pension të posaçëm shtetëror, kur nuk përfitojnë, sipas përcaktimit në shkronjat “a” e “b” të këtij vendimi.

ç) personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.

d) personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarakë, sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror, suplementar, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, si dhe personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si punonjës të Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlllogariten në shumën 2 780 000 000 (dy miliardë e shtatëqind e tetëdhjetë milionë) lekë dhe do të përballohen nga Buxheti i Shtetit. Fondi prej 2 780 000 000 (dy miliardë e shtatëqind e tetëdhjetë milionë) lekësh do të përdoret, përkatësisht:

a) 2 751 000 000 (dy miliardë e shtatëqind e pesëdhjetë e një milionë) lekë, për asistencën e menjëhershme të pensionistëve;

b) 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekë, për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet administrative.

3. Procedurat e pagesës dhe të administrimit të asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha